



RAPORT PËRMBLEDHËS – NËNTOR 2013

**Progresi dhe Hapat e Mëtejshëm Drejt Zgjidhjes së një
Ankese në Lidhje me Projektin e Bankers Petroleum (IFC Project #27306)**

Tiranë & Patos, Shqipëri

1 Dhjetor 2013

*Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë Ombudsman
Korporata Financiare Ndërkombëtare /
Agjencia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve*

www.cao-ombudsman.org

1. Historik & Përshkrim

Ky Raport Përmbledhës përshkruan progresin e bërë drejt zgjidhjes së një ankese të dërguar në CAO në Mars 2013 nga një ekspert mjedisor shqiptar në emër të banorëve të Zharrëzës, një komunitet që gjendet pranë fushës naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Ankuesi ka ngritur disa shqetësime në lidhje me aktivitetet nxjerrëse të Bankers Petroleum Albania Ltd (BPAL). Në Maj 2013, një ekip i CAO udhëtoi në Shqipëri për të kryer një vlerësim të çështjeve dhe ideve të palëve të interesuara për zgjidhjen e tyre.

Ekipi vlerësues gjeti që ngjarjet sizmike (dhe dëmet që rezultojnë në shtëpitë dhe ndërtesat) afër komunitetit të Zharrëzës është një shqetësim mbizotërues në rradhët e palëve të interesuara. Përgjithësisht ekziston një pajtim mes banorëve të Zharrëzës, përfaqësuesve të BPAL dhe përfaqësuesve të sektorit publik që kjo çështje do të merrte përgjigje më përfundimtare nëpërmjet informacionit teknik më të mirë e më të besueshëm. Gjithashtu palët bien dakord që një hulumtim i tillë duhet të hartohet me bashkëpunim dhe duhet të përfshijë ekspertë të besueshëm të pavarur të cilët janë të specializuar në sizmologji në kontekstin e naftës dhe gazit.

Me kërkesën e palëve të interesuara, CAO ra dakord të identifikojë dhe të mbështesë një ekip lehtësues për të ndihmuar në mbledhjen dhe fillimin e një grupi pune bashkëpunues me detyrë shqyrtimin e çështjeve teknike dhe shkencore, duke mbledhur cdo informacion shtesë që gjykohet i nevojshëm nga grupi dhe duke nxjerrë një raport të pavarur. (Një proces i tillë, shpesh i referuar si një “gjetje faktesh e përbashkët”, është një strategji që mundëson ekspertët teknikë, vendim-marrësit dhe të tjerët nga palët në pozicione të kundërt të një problemi, të punojnë së bashku për të trajtuar mosmarrëveshjet mbi faktet).

Gjithashtu, me kërkesë të ankuesve dhe kompanisë, CAO ra dakord të fillojë lehtësimin e këtij procesi vetëm pas zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, në Qershor 2013, dhe pasi të ishin emëruar ministrat e rinj dhe drejtorët e rinj të kabinetëve. Ekipi i CAO filloi pastaj të takohej me palët në Tetor 2013.

2. Përmbledhje dhe Rezultate të Vizitës së Ekipit Lehtësues të CAO – Tetor 2013

Disa javë përpara vizitës së tyre në Tetor, ekipi lehtësues i CAO mësoi që Ministri i ri i sapo zgjedhur i Energjisë, Z. Damian Gjiknuri, kishte krijuar një grup pune me detyrën për të identifikuar shkaqet e tërmeteve afër Zharrëzës. Me qëllim që të shmangë mbivendosjen e përpjekjeve dhe pështjellimin e mundshëm rreth procesit të ndarë të CAO për gjetjen e fakteve, CAO ofroi të punojë në bashkëpunim me zyrën e Ministrit Gjiknuri për të mbështetur dhe përforcuar përpjekjet e tij për të zgjidhur këto çështje.

Nga data 28 Tetor në 1 Nëntor, ekipi lehtësues u takua me një numër palësh të interesuara për të shqyrtuar gjetjet e vlerësimit, për të mbledhur idetë për një kuadër të propozuar të procesit të përbashkët për gjetjen e fakteve, dhe për të zhvilluar konsensusin mbi hapat e mëpasshëm. Këto palë të interesuara, të renditur më poshtë, përfshinin ankuesin, banorët e Zharrëzës të cilët mbështetën dorëzimin e ankesës në CAO, përfaqësuesit e BPAL dhe përfaqësues kyc të sektorit publik. Ata renditen sipas radhës së takimeve të bëra nga CAO:

- Sazan Guri – Ambjentalist, ankues në CAO, dhe anëtar i Grupit të Punës së Ministrit për shkaqet e tërmeteve në Zharrëz
- Shkelqim Grembi – Banor i Zharrëzës dhe bashkë-ankues, në përfaqësim të banorëve lokalë të cilët e mbështetën ankesën e CAO

- Rrapo Ormeni (Drejtor) dhe Edmond Dushi, Departamenti i Sizmologjisë, Instituti i Gjeoshkencave dhe anëtarë të Grupit të Punës së Ministrit për shkaqet e tërmeteve në Zharrëz
- Stavri Dhima – Drejtor i Departamentit të Hidrokarbureve, Republika e Shqipërisë.
- Barbara Lamb dhe Sally Davidson, Menaxhere të Marrëdhënieve me Komunitetin, BPAL
- Këshilli i Komunës të Zharrëzës (17 anëtarë)
- Matilda Baja – Administrata e Zharrëzës dhe anëtare e Grupit të Punës së Ministrit për shkaqet e tërmeteve në Zharrëz
- Majlinda Bufi, Anëtare e Kuvendit të Shqipërisë (rajoni i Fierit)
- Dael Dervishi – Drejtor Ekzekutiv, Agjencia Kombëtare e Burimeve natyrore (AKBN), dhe anëtar i Grupit të Punës së Ministrit për shkaqet e tërmeteve në Zharrëz
- Damian Gjijnuri – Ministër i Energjisë dhe Industrisë, Republika e Shqipërisë
- Ardit Kamberi – Drejtor Kabineti për Ministrin e Energjisë Gjijnuri.
- Djana Bejko – Zëvendës Ministre e Mjedisit, Republika e Shqipërisë

2.1 Interesa të përbashkëta

Këto palë të interesuara shprehën mbështetje të përgjithshme për një qasje bashkëpunuese të bazuar në dialog për (a) kuptimin më të mirë të shkaqeve të tërmeteve në Zharrëz, dhe (b) përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit të Zharrëzës dhe BPAL. Gjithashtu kishte një pajtim të përgjithshëm në rradhët e shumicës së palëve të interesuara që:

- Nevojitet informacion më shkencor për të kuptuar më mirë shkaqet e tërmeteve afër fushës naftëmbajtëse Patos-Marinëz, dhe vendosja e seizmometrave pranë zonës është një hap kryesor drejt grumbullimit të këtij informacioni.
- Vendosja e seizmometrave dhe menaxhimi i të dhënave të gjeneruara prej tyre duhet të përfshijë specialist të pavarur si dhe BPAL, për të siguruar transparencë dhe informacion që është gjerësisht i besueshëm.
- Grupi i punës së Ministrit të Energjisë është një proces i rëndësishëm që sinjalizon angazhim të fortë të sektorit publik në zgjidhjen e problemeve.

2.2 Cështje për Shqyrtim të Mëtejshëm Issues for Further Consideration

Bazuar në takimet dhe bashkëbisedimet e CAO me palët e interesuara, ka disa tema që duhet ende të diskutohen dhe për të cilat palët të bien dakord me qëllim që të arrihen zgjidhje afat-gjata. Këto përfshijnë (a) vendosjen dhe administrimin e seizmometrave, (b) pritshmëritë dhe hapat e mëtejshëm për Grupin e Punës së Ministrit, dhe (c) komunikimi ndërmjet banorëve të Zharrëzës dhe BPAL.

(a) Vendosja dhe Menaxhimi i Informacionit të Seizmometrave

Banorët e Zharrëzës dhe të tjerët filluan të ngrënë shqetësimet e tyre rreth shkaqeve të tërmeteve në vitin 2009. Që nga ajo kohë, BPAL ka marrë ankesa të shumta që pretendojnë që aktivitetet e saj shkaktojnë ose përkeqësojnë fenomenet sizmike. Në përpjekje të ndryshme për t'ju përgjigjur këtyre pretendimeve dhe për të zgjidhur ankesat, BPAL ka ndër marrë hapa të shumtë për të monitoruar dhe dokumentuar aktivitetin sizmik në zonë, përfshirë raporte të analizës të të dhënave, kontraktimi i sizmologëve dhe gjeofizikanëve të pavarur, duke thirrur dhe marrë pjesë në takime të komunitetit dhe fillimin e një "Projekti për Instalimin e Seizmografëve".

Ndërkohë që disa banorë dhe zyrtarë të sektorit publik besojnë që përpjekjet dhe informacioni i BPAL janë jobindëse, instalimi i seizmografëve pranë zonës së prekur është një nismë e cila aktualisht ka një masë të madhe mbështetjeje nga komuniteti dhe sektori publik. Projekti i Instalimit të Seizmografëve përfshin blerjen nga BPAL të dy seizmografëve, dhe bashkëpunimin shkencor me Institutin Kombëtar Sizmik për të përzgjedhur vendet e përshtatshme për pajisjet dhe për të monitoruar informacionin pasi të jenë instaluar këto pajisje.

Pavarësisht nga marrëveshja e tyre fillestare në parim dhe disa përpjekjeve gjatë vitit të kaluar për të finalizuar këtë projekt, BPAL dhe Instituti Kombëtar Sizmik nuk kanë qenë në gjendje të konkludojnë një marrëveshje formale të bashkëpunimit shkencor. Palët kanë identifikuar disa arsye për vonesën në përfundimin e marrëveshjes. Megjithatë, duke pasur parasysh konsensusin aktual në rradhët e ankuesve dhe një vargu më të gjerë të palëve të interesuara që instalimi i seizmometrave është thelbësor për të kuptuar shkakun e tërmeteve në Zharrëz, finalizimi i kësaj marrëveshjeje është një hap vendimtar për zgjidhjen e ankesave.

(b) Pritshmëritë dhe Hapat e Mëtejshëm për Grupin e Punës së Ministrit

Në 18 Tetor 2013, Ministri i Energjisë Gjijnuri nxori një urdhër për krijimin e një grupi pune “për vlerësimin e shqetësimeve të banorëve të Komunës Zharrëz, Fier, të cilat lidhen me fenomenin e lëkundjeve të tokës në zonën rrotull, ku kryhen operacione të hidrokarbureve për nxjerrjen e naftës nga rezervuari në Patos-Marinëz.” Grupi i punës përbëhet nga përfaqësues nga Ministria e Energjisë, Albpetrol (kompani shtetërore naftë), Instituti Kombëtar Sizmik dhe AKBN, di dhe një përfaqësuese e komunitetit nga Zharrëza dhe ankuesi. Urdhëri i nxjerrë udhëzon këtë grup pune për të ofruar një shpjegim mbi shkaqet e lëkundjeve deri në fund të vitit kalendarik 2013.

Ankuesi, banorët e Zharrëzës dhe zyrtarët e sektorit publik besojnë që ky grup pune është një mekanizëm i rëndësishëm dhe i besuar për të kuptuar më mirë shkakun e tërmeteve në Zharrëz. Në këndvështrimin e tyre, kjo thekson dhe angazhimin e Ministrit të ri ndaj sigurisë dhe mbrojtjes së komuniteteve dhe mjedisit.

Së bashku me këtë mbështetje të fuqishme, palët e interesuara shfaqën disa shqetësime në lidhje me mandatin e grupit të punës dhe raportin final. Ndërmjet tyre:

- Meqenëse seizmometrat nuk janë instaluar ende, dhe në dritë të konsensusit të gjerë ndërmjet palëve të interesuara që seizmometrat janë të nevojshëm për të marrë të dhëna afat-gjata, të bazuara në vendndodhje, ka shqetësim nga disa që cdo përfundim i grupit të punës përpara instalimit të seizmometrave do të jetë jopërfundimtar.
- Kuadri kohor dy-mujor për vlerësimin e informacionit ekzistues teknik seizmologjik dhe hartimi i një raporti përfundimtar të dobishëm është një shqetësim për disa palë të interesuara. Edhe disa anëtarë të grupit të punës shprehën rezerva rreth kohës së shkurtër në dispozicion të kryerjes së kësaj detyre.
- Pritshmëritë janë të larta në rradhët e shumë anëtarëve të komunitetit në lidhje me përfundimet e grupit të punës. Disa anëtarë të grupit të punës janë të shqetësuar që këto pritshmëri mund të jenë të vështira për tu menaxhuar.

- Askush nga BPAL nuk po merr pjesë aktualisht në këtë grup pune, dhe disa palë të interesuara – përfshirë BPAL – e shohin këtë si dëmtues ndaj një rezultati të besueshëm.

Ekipi i CAO i diskutoi këto shqetësime me Ministrin Gjijnuri dhe Drejtorin e Kabinetit të tij, të cilët përgjithësisht ranë dakord që problemet, nëse nuk menaxhohen sic duhet, mund të paraqesin rreziqe të mundshme ndaj suksesit afat-gjatë dhe besueshmërisë së grupit të punës.

(c) Komunikimi ndërmjet banorëve të Zharrëzës dhe BPAL.

Konflikti ndërmjet Zharrëzës dhe BPAL ka vazhduar për disa vjet, dhe në disa moment është përshkallëzuar deri në përplasje kërcënuese. Si anëtarët e këshillit të komunës Zharrëz dhe stafi i BPAL shprehin irritim të vazhdueshëm rreth mungesës së besimit dhe komunikimit të dobët që ekziston ndërmjet tyre. Anëtarët e këshillit thonë që kompania i ka injoruar shqetësimet dhe kërkesat e komunitetit për informacion më të mirë, garanci të sigurisë dhe mundësi ekonomike. BPAL thotë që kompania ka bërë përpjekje të shumta për tu angazhuar me Zharrëzën, por që banorët kanë refuzuar të marrin pjesë në dialogë apo grupe pune të propozuar nga kompania të fokusuar mbi tërmetet dhe çështje të tjera sociale dhe mjedisore.

Nga këndvështrimi i ekipit lehtësues, kapërcimi i këtyre sfidave dhe gjetja e mënyrave për tu angazhuar në mënyrë më productive është i rëndësishëm jo vetëm për trajtimin e shkaqeve dhe ndikimeve të fenomeneve sizmike, por edhe për shëndetin dhe perspektivën afatgjatë të komunitetit.

3. Hapat e Mëtejshem

Duke pasur parasysh objektivat e mbivendosur të grupit të punës së Ministrisë dhe procesi i përbashkët i gjetjes së fakteve që rrjedh nga vlerësimi i ankesës nga CAO, ekipi i CAO kërkoi një mendim të sqartë nga të gjithë palët e interesuara nëse ka një rol për CAO në lehtësimin e një zgjidhjeje të ankesës.

Ministria e Energjisë, Instituti Kombëtar Sizmik dhe zyrtarë të tjerë publikë shprehën interes në vazhdimin e përfshirjes së CAO për të lehtësuar hapat e mëtejshëm pasi grupi i punës të nxjerrë gjetjet e tij. Ankuesit dhe banorët e Zharrëzës shprehën një këndvështrim të ngjashëm, duke shtuar që një proces i ndërmjetësuar dialogu ndërmjet Zharrëzës dhe BPAL mund të përmirësojë kanalet e komunikimit dhe të sjellë angazhim më produktiv për një numër çështjesh. Edhe BPAL shprehu mbështetje për vazhdimin e përfshirjes së CAO, duke deklaruar që përpjekjet e tyre të shumta të mëparshme për tu përfshirë me banorët dhe udhëheqësit publikë rreth çështjes së tërmeteve përgjithësisht nuk janë mirëpritur ose besuar nga banorët e Zharrëzës. Kompania gjithashtu ritheksoi interesin e saj për të marrë pjesë në një proces afat-gjatë bashkëpunues për gjetjen e fakteve të fokusuar mbi ndikimet e operacioneve të saj.

Në dritën e mbështetjes së vazhduar të palëve të interesuara për përfshirjen e CAO, dhe në përgjigje të çështjeve të përshkruara më sipër, ekipi lehtësues (duke punuar brenda mandatit të tij të parashkruar) do të vazhdojë:

- Të mbështesë përpjekjet në proces të Ministrisë së Energjisë, BPAL dhe Institutit Kombëtar Sizmik për të finalizuar marrëveshjen mbi instalimin e seizmometrave pranë vendit të projektit. CAO lehtësoi një takim fillestar (25 Nëntor 2013) duke përfshirë këto palë të interesuara dhe zyrtarë të tjerë të sektorit publik, në të cilën palët diskutuan hapat e mëtejshëm drejt finalizimit të një projekt “Marrëveshje Bashkëpunimi” ndërmjet BPAL dhe Institutit Kombëtar Sizmik. CAO do të vazhdojë të ndihmojë palët të shkojnë drejt plotësimit të këtij qëllimi.
- Të lehtësojë një “dialog fillestar” ndërmjet Këshillit të Komunës Zharrëz dhe stafit të BPAL përpara fundit të vitit kalendarik 2013 ose në fillim të vitit 2014, për t’i ndihmuar të identifikojnë çështje kryesore dhe strategji për bashkëpunimin afat-gjatë dhe për tu përgatitur për hapat e mëtejshëm pas daljes së gjetjeve të grupit të punës së Ministrit.
- Të punojë me sektorin publik, BPAL dhe ankuesit – nëse këto palë e kërkojnë një gjë të tillë, pas daljes së raportit të grupit të punës – rreth hartimit dhe fillimit të një grupi pune të lehtësuar apo procesi të përbashkët gjetjesh faktesh më afat-gjatë.